



Prishtinë, 05.09.2022

Kodi i ZRRE-së: V_1586_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2339_07_22** i dt.26.07.2022;
- Ankesa e konsumatorit e datës **22.08.2022**,

në seancën e mbajtur më datë 05.09.2022 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit E.B nga komuna e Prishtinës, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me nr. ZRRE/DMK_V_2339_07_22, i datës 26.07.2022.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me datë 26.07.2022 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2339_07_22 me të cilin e ka aprovuar ankesën e konsumatorit E.B, e ka obliguar KESCO-n të anulojë korigjimin nr. 99860DPR-90152615 datë 16.05.2022 në vlerë **-167.65€** dhe të bëjë korigjimin e faturave 12/2021 deri në periudhën 03/2022 në vlerë **-469.35€** dhe ka kërkuar që KESCO ti ofroj konsumatorit kontratë pagese 4 mujore.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori E.B brenda afatit ligjor ka paraqitur Ankesë në Bordin e ZRRE-së, për këto shkaqe:

- Me vendimin e atakuar nuk është shqyrtuar plotësisht ankesa e konsumatorit dhe për më tepër është lënë në fuqi vendimi i KEDS-it, edhe pse në pikën 1 dhe 2 është aprovuar kërkesa.
- Për konsumatorin është e paqartë fakti se në njëren anë aprovohet ankesa e konsumatorit, ndërsa në anën tjetër i ofrohet mundësia e pagesës për katër (4) muaj.
- Konsumatori kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të shfuqizojë dhe ta kthej në rivendosje ose të ndryshoj vendimin nr. 291/22 dhe të korigjoj faturën e muajit Mars 2022.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 05.09.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin e konsumatorit se është e paqartë fakti se në njëren anë aprovohet ankesa e konsumatorit, ndërsa në anën tjetër i ofrohet mundësia e pagesës për katër (4) muaj, Bordin thekson se, pasi është analizuar çdo provë veç e veç dhe në ndërlidhje me njëra tjetrën, si në vijim: Fatura nr. 03220DPR-90152615 datë 30.03.2022; Ankesa e konsumatorit në KESCO datë 31.03.2022; Procesverbali i inspektimit nr. 1740323 datë 01.04.2022; Procesverbali mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit nr. 0001069 datë 07.04.2022; Përgjigja e KESCO-s e datës 26.05.2022; Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 27.05.2022; Rrjedha e energjisë elektrike dhe listat e leximit; Korigjimi nr. 99860DPR-90152615 datë 16.05.2022; Vendimi i DMK-së ZRRE/DMK_V_2339_07_22, i datës 26.07.2022, ka ardhur në përfundim se DMK ka shqyrtuar korigjimin e bërë nga Departamenti i



faturimit në KESCO dhe konstaton se KESCO ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, por që në rastin e konsumatorit KESCO është dashur të bëjë shpërndarjen e kWh të faturuar nga periudha 12/2021 deri në periudhën 03/2022 duke bërë korrigjimin e këtyre faturave në vlerë **-469.35€**. Bazuar në këto shqyrtime dhe analiza, Bordi gjeti se ankesa e konsumatorit E.B, është e pabazuar.

Bordi pas analizimit të të gjitha dëshmimeve të paraqitura nga ana e konsumatorit dhe të licencuarit KESCO, ka vërejtur se, fillimisht, Departamenti i faturimit në KESCO me datë 30.03.2022 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën mars 2022 me **16,811 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **1,577.56€**. Me datë 31.03.2022 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kërkuar që ti behet ri shqyrtimi i faturës nr. 03220DPR-90152615 datë 30.03.2022, për shkak të dyshimit të leximit dhe faturimit jo të saktë të njehsorit elektrik nr. 75161229. Më tutje, me datë 01.04.2022 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 75161229 ku TL=009898 kWh dhe TU=010438 kWh. Ekipi i KEDS-it po ashtu ka evidentuar të dhënat teknike të pikës matëse si dhe ka evidentuar që njehsori nga jashtë duket në rregull dhe se leximi i shpenzimeve të konsumatorit bëhet me sondë. Me datë 07.04.2022 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrimin e njehsorëve elektrik kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 75161229 me gjendje TL=10025 kWh dhe TU=10926 kWh si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 58117193 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Me datë 26.05.2022 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e aprovuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike, procesverbalit të inspektimit nr. 1740323 datë 01.04.2022 si dhe procesverbalit mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit nr. 0001069 datë 07.04.2022. Me datë 27.05.2022 konsumatori ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjen e lëshuar nga KESCO si dhe ka kërkuar ti behet ri shqyrtimi i faturës nr. 03220DPR-90152615 datë 30.03.2022, për shkak të dyshimit të leximit dhe faturimit jo të saktë të njehsorit elektrik nr. 75161229.

Bordi i ZRRE-së e ka analizuar edhe korrigjimin e faturës dhe ka vërejtur se, Departamenti i faturimit në KESCO përmes korrigjimit nr. 99860DPR-90152615 ka bërë korrigjimin në vlerë **-167.65€** duke bërë shpërndarjen e kWh të faturuara për periudhën 02/2022 deri në periudhën 03/2022 për shkak të faturimit pa matje. Bordi ka shqyrtuar korrigjimin e bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO dhe konstaton se KESCO ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: 3. *Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese*, por që në rastin e konsumatorit KESCO është dashur të bëjë shpërndarjen e kWh të faturuar nga periudha 12/2021 deri në periudhën 03/2022 duke bërë korrigjimin e këtyre faturave në vlerë **-469.35€**.

ZRRE është ndalur edhe në shqyrtimin e analizës së përgjithshme të energjisë elektrike si dhe listave të leximit me njehsorët elektrik nr. 75161229 dhe nr. 58117193, nga të cilat konstatohet se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore përveç periudhës 12/2021 dhe 01/2022 kur lexuesi ka evidentuar se leximi bëhet në mënyrë manuale kurse në periudhat 02/2022 dhe 03/2022 është evidentuar si faturim CCP. Bordi me qëllim që të bëjë analizën e shpenzimeve të konsumatorit ka bërë krahasimin e shpenzimeve me dy njehsorët, njehsorin nr. 75161229 dhe njehsorin e ri nr. 58117193 dhe konstaton se shpenzimi i faturuar për periudhën 03/2022 dallon me shpenzimet e periudhave të njëjta të më hershme si dhe periudhave të më vonshme si dhe paraqet grumbullim të kWh, me çka edhe vërtetohet se faturimi i shpenzimeve të periudhës 03/2022 është në kundërshtim me nenin 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: 1. *Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë*



e shpenzuar r dhe për tarifën tjetër, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme), 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit.

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 05.09.2022 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit E.B dhe
- Arkivit të ZRRE-së.